



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 27.07.2022

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.24 datë 05.03.2021 “Mbi miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”, me propozimin e Bashkisë Durrës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Sistemet territoriale të propozuara;
 - iii. Ndarja e territorit në zona dhe njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Durrës shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.



3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësishme Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësishme Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Durrës duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Durrës për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentat e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Durrës përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
 - Vendim Nr.8, datë 11.01.1996 “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Durrësit”;
 - Vendim Nr.9, datë 11.08.1999 “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit Durrës”;
 - Vendim Nr.1, datë 02.09.1999 “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Durrësit”;
 - Vendim Nr.14, datë 18.06.2003 “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Durrësit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre”;
 - Vendim Nr.3, datë 30.07.2004 “Për miratimin e detyrës së projektimit për rikonceptimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Durrësit dhe vijës kufizuese të kësaj qendre”;
 - Vendim Nr.3, datë 26.10.2007 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Durrësit”;
 - Vendim Nr.2, datë 14.07.2009 “Për miratimin e Masterplanit për zhvillimin e integruar të zonës energjetike dhe industriale të Porto Romanos – Durrës, infrastruktura dhe vija kufizuese e saj”;
 - Vendim Nr.27, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”;
 - Vendim Nr.13, datë 04.07.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, komuna Ishëm, qarku Durrës”.
7. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, datë 15.04.2021 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Durrës”, shfuqizohet.
8. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA ROTA

